



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN, Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më: 20 Maj 2010
Ref. Nr.:RK.22/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMERI

Lënda Nr. KI 22/09

Dedë Gecaj

kundër

Vendimit Nr. PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 6 prill 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Dedë Gecaj, i përfaqësuar në procedurën para Gjykatës Kushtetuese nga Kolë Krasniqi, avokat në Pejë.

Vendimi i sfiduar

2. Në kërkesën e tij, parashtruesi sfidon Vendimin Nr. PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 6 prill 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkohet në Zvicër për kryerje të supozuar të veprave penale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Zvicër. Megjithatë, ai u arratis, por u arrestua në

Serbi dhe u gjykua për disa nga veprat penale. Në pritje të vendimit të Gjykatës Supreme të Serbisë për kërkesën e tij për rishikim, ai u lirua nga paraburgimi. Pasi Gjykata Supreme e Serbisë konfirmoi shpalljen e tij fajtor me 22 mars 2002, parashtruesi nuk u paraqit për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.

4. Parashtruesi u arrestua në Kosovë në maj të viti 2006, por u lirua në pritje të procedurave të iniciuara nga autoritetet zvicerane me Misionin e OKB-së në Kosovë për ta transferuar atë në Zvicër. Marrëveshja për transferimin e tij në Zvicër u nënshkrua, por parashtruesi e sfidoi atë në gjykatë. Më 6 prill 2009, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi në instancën e fundit, që marrëveshja ishte e vlefshme. Parashtruesi pohon se transferimi i tij në Zvicër do ta ekspozonte atë një lloj trajtimi që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe instrumentet për të drejtat e njeriut.

Baza juridike

5. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej: Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me 22 qershor 2009, kurse me 17 shtator 2009, ai e plotësoi atë me një Kërkesë për masë të përkohshme, veçanërisht, pezullimin e procedurës për transferimin e tij në Zvicër. Me 15 dhjetor 2009, Gjykata vendosi të hidhte poshtë kërkesën për masë të përkohshme të parashtruesit.

Përmbledhje e fakteve

7. Më 11 janar 1999, mësuesi i bijës së Parashtruesit u vra në St. Gallen, Zvicër. Sipas autoriteteve zvicerane, mësuesi, i cili ishte në dijeni të faktit se parashtruesi abuzonte seksualisht vajzën e tij, u vra nga parashtruesi për ta eliminuar atë si dëshmitar. Parashtruesi u arratis dhe tani kërkohet nga autoritetet zvicerane për kryerje të supozuar të veprave penale të vrasjes; mbase vrasje me paramendim; akte të shumta seksuale me një fëmijë; shkaktim të lëndimeve të shumta trupore; përdhunime të shumta; detyrime të shumta me forcë; akuzime të rreme dhe/apo nxitje; dhunë dhe kërcënime ndaj autoriteteve dhe oficerëve; dhe akte të dënueshme paraprake për vrasje me paramendim apo rrëmbim.

8. Më 25 shkurt 1999, parashtruesi u arrestua në Gjakovë dhe u mbajt në paraburgim në pritje të gjykit të tij në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Pas hyrjes në fuqi të Rezolutës 1244 në vitin 1999 dhe pasi Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK) kishte marrë përsipër, inter alia, administrimin e drejtësisë, Gjykata Supreme e Serbisë vendosi t'ia besonte rastin Gjykatës së Qarkut në Leskovc, e cila më 7 dhjetor 2000, e shpalli parashtruesin fajtor për vrasje dhe e dënoi me 4 vjet burg. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Serbisë, e cila e liroi atë në pritje të procedurave të apelit.

9. Më 28 mars 2002, Gjykata Supreme e Serbisë konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Për më tepër, me 28 maj 2003, Gjykata vendosi t'ia zvogëlonte dënimin parashtruesit në tre vjet e gjashtë muaj dhe të llogariste kohën që tashmë e kishte kaluar në paraburgim. Parashtruesi nuk u paraqit për ta vuajtur pjesën e mbetur të dënimit, por mbeti në arrati.

10. Më 19 maj 2003, autoritetet zvicerane lëshuan urdhër arrest për parashtruesin në bazë të veprave penale të sipërpërmendura (shihni paragrafin 7) dhe, me 22 shkurt 2006, arritën një marrëveshje me UNMIK-un për transferimin e tij në Zvicër në rast se ai do të arrestohej.

Ai u arrestua sërish në Kosovë më 4 maj 2006, por u lirua të njëjtën ditë nga gjyqtari i procedurës paraprake në Pejë. Me 7 maj, Gjykata e Qarkut në Pejë urdhëroi paraburgimin e parashtruesit, por ai nuk u arrestua deri me 13 gusht 2007. Ai u lirua nga paraburgimi më 17 gusht 2007.

11. Më 20 gusht 2007, autoritetet zvicerane lidhën një Marrëveshje të re me UNMIK-un për transferimin e parashtruesit në Zvicër. Me vendimin e datës 5 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Pejë konfirmoi transferimin e parashtruesit. Më 28 mars 2008, Gjykata Supreme e Kosovës mbështeti ankesën e parashtruesit kundër konfirmimit të Gjykatës së Qarkut dhe hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për transferimin e tij në Zvicër. Më 24 korrik 2008, Prokurori Publik paraqiti një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër këtij vendimi.

12. Me vendimin e datës 6 prill 2009, Gjykata Supreme miratoi kërkesën e Prokurorit Publik për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe vendosi që transferimi i parashtruesit në Zvicër në bazë të Marrëveshjes së lidhur më 20 gusht 2007 ndërmjet autoriteteve zvicerane dhe UNMIK-ut ishte ende i vlefshëm, në pajtim me Nenin 145 (vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e legjislacionit përkatës) të Kushtetutës së Kosovës.

13. Lidhur me "historinë procedurale", Gjykata Supreme vendosi që parashtruesi ishte dënuar për vepër penale të vrasjes nga një gjykatë serbe dhe se "vendimi nuk mund të merret parasysh në perspektivën e zbatimit të parimit *"ne bis in idem"*, pasi marrëveshja për transferim qartazi përcakton që transferimi nuk do të lejohet, nëse parashtruesi është shfajësuar apo dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga një gjykatë në Kosovë për një vepër penale për të cilën transferimi kërkohet (Neni 5.g i Marrëveshjes në fjalë), me përjashtim të aktgjykimeve të gjykatave jo-vendore."

Pohimet e parashtruesit

14. Parashtruesi thekson se rasti i tij penal ishte gjykuar në instancën e fundit nga Gjykata Supreme e Serbisë me 28 mars 2002. Prandaj, vendimi i Gjykatës Supreme i datës 6 prill 2009 ka shkelur:

- Parimet themelore të GJEDNJ-së, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kushtetutën e Kosovës, dhe të drejtën ndërkombëtare publike;
- Konventën Evropiane mbi Ekstradim së datës 13 dhjetor 1957 dhe protokollet e saj të vitit 1975 dhe 1978;
- Parimet e ligjit mbi procedurën penale;
- Nenet 451.1, 452.3, dhe 457.7 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK).

15. Për më tepër, vendimi i Gjykatës Supreme, i datës 6 prill 2006, shkel Nenin 517.9 të KPPPK-së, i cili kërkon që transferimi i personit në një shtet të huaj lejohet vetëm nëse nuk ekziston rrezik real që personi, transferimi i të cilit kërkohet, të trajtohet ose dënohet në mënyrë çnjerëzore ose degraduese.

16. Sipas Parashtruesit, autoritetet zvicerane kanë *"dëshmuar qëndrim të paligjshëm diskriminues, degradues dhe sjellje hakmarrëse vetëm për shkak të prejardhjes së tij kombëtare, respektivisht për shkak të urrejtjes ndaj të huajve"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

17. Parashtruesi ankohet për shkelje të parimit *"Ne Bis In Idem"*, siç ceket në Nenin 34 të Kushtetutës, i cili parashihet që *"Askush nuk mund të gjykohej më tepër se një herë për të njëjtën vepër penale"*, një parim i cili, sipas mendimit të Gjykatës, është i përgjithshëm.

Megjithatë, çështja nuk është nëse parashtruesi do të rigjykohej nga gjykatat e Kosovës, por, siç ka cekur edhe vetë në mënyrë të qartë, nëse do të rigjykohej në Zvicër për të njëjtat vepra penale për të cilat është gjykuar nga Gjykata Supreme e Serbisë në instancën e fundit. Në këto rrethana, parashtruesit i takon ta ngrejë këtë çështje me autoritetet zvicerane, kur të transferohet në Zvicër, dhe të kërkojë nga ata që ta zbatojnë parimin e lartpërmendur.

18. Për më tepër, Marrëveshja që mundëson transferimin e parashtruesit në Zvicër është lidhur ndërmjet autoriteteve zvicerane dhe UNMIK-ut më 20 gusht 2007. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje u konfirmua në instancën e fundit nga Gjykata Supreme e Kosovës më 6 prill 2009, duke vendosur që parashtruesi "ishte dënuar për vrasje nga një gjykatë serbe" dhe se "transferimi nuk do të lejohet nëse personi është shfajësuar apo dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga një gjykatë në Kosovë për një vepër penale për të cilën kërkohet transferimi (Neni 5(g) i Marrëveshjes)", me përjashtim të aktgjykimeve të gjykatave jo-vendore".

19. Prandaj, Gjykata konstaton që, pasi procedurat penale kundër parashtruesit mbaruan me dënim të formës së prerë për rastin e tij nga një gjykatë jo-vendore, domethënë nga Gjykata Supreme e Serbisë, nuk mund të konsiderohet që marrëveshja në fjalë e shkel parimin e mësipërm.

20. Parashtruesi gjithashtu ankohet që vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 6 prill 2007, që konfirmon transferimin e tij në Zvicër, e shkel Nenin 517.9 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), i cili ndalon transferimin në një shtet të huaj në të cilin parashtruesi do të rrezikonte t'i nënshtrohej trajtimit ose dënimit në mënyrë johumane ose degraduese. Sipas mendimit të tij, autoritetet zvicerane kanë "dëshmuar qëndrim të paligjshëm diskriminues, degradues dhe hakmarrës vetëm për shkak të prejardhjes së tij kombëtare, respektivisht për shkak të urrejtjes ndaj të huajve".

21. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Soering (Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, seria A, Nr. 161, Appl. Nr. 14038/88) në të cilin GJEDNJ konsideronte se ekstradimi do të mund të refuzohej në rrethana në të cilat parashtruesi ka vuajtur apo rrezikon të vuajë mohim flagrant të një gjykimi të drejtë në shtetin që e kërkon atë.

22. Megjithatë, Gjykata konstaton që parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi çfarëdo qoftë që transferimi i tij në Zvicër do t'i shkelte parimet themelore të të drejtave të njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare, të cekura nga ai, apo që ai do t'u dorëzohej autoriteteve zvicerane për trajtim në kundërshtim me Nenin 517.9 të KPPPK-së, i cili kërkon që transferimi i personit në një shtet të huaj lejohet vetëm nëse nuk ekziston rrezik real që personi, transferimi i të cilit kërkohet, të trajtohet ose dënohet në mënyrë johumane ose degraduese.

23. Prandaj, rezulton që Parashtruesi nuk i ka përmbushur kriteret për dorëzimin e kërkesës siç ceket në Nenin 22.1 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 20 të Ligjit, si dhe Nenin 54(b) të Rregullores së Punës, njëzëri,

VENDOS

I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. Ky vendim do t'u njoftohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Prof. Dr. Gjyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani